



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 25.2.2025

Nr: 184

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE PARTIA “RRUGA E VËRTETË SHQIPTARE”, ME KRYETAR Z. MUHARREM DODA, PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025

Sot më datë 25.2.2025, në seancë publike mora në shqyrtim kërkesën nr. 1265 Prot., datë 24.02.2025, me:

Kërkues: Partia politike Partia “Rruga e Vërtetë Shqiptare”, me Kryetar Z. Muharrem Doda.

Objekti: Regjistrimi i partisë politike Partia “Rruga e Vërtetë Shqiptare” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025.

Baza ligjore: Neni 64 të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 399, datë 5.12.2024 ka caktuar datën 11 Maj 2025 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvend.

Partia “Rruga e Vërtetë Shqiptare”, me Kryetar, Z. Muharrem Doda, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2025.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, datë 31.01.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se Partia “Rruga e Vërtetë Shqiptare”, me initiale “P.R.V.SH”, me Kryetar Z. Muharrem Doda, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.
- Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02)
- Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03)

Data: 25.2.2025 Nr: 184
Ora: 14:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike Partia “Rruga e Vërtetë Shqiptare” me Kryetar z. Muharrem Doda, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025”

Nga dokumentacioni si më sipër dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Ruga e Vërtetë Shqiptare” me shkronja nistore “P.R.V.SH”, me adresë: Rruga "Fuat Toptani", Nr.270,Tiranë;
- b) Kryetar i partisë është Z. Muharrem Doda, me adresë: Rruga "Fuat Toptani", Nr.270, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është Z. Shefqet Lusha, me adresë: Rruga “Don Bosko” Pll Gener 2, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është Z. Etmond Bici, me adresë: Rruga "Fuat Toptani", Nr.270,Tiranë
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga Partia “Ruga e Vërtetë Shqiptare”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga Partia “Ruga e Vërtetë Shqiptare” është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, 64 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 22.01.2025, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 Maj 2025.

V E N D O S :

1. Regjistrimin e partisë politike Partia “Ruga e Vërtetë Shqiptare”, me Kryetar Z. Muharrem Doda, me shkronjat nistore “P.R.V.SH”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI